

## LIRIKA E SHPIRTIT

Vëllimi me tregime të zgjedhura lirike *“Pena e vjeshtës së artë”* nuk synon të shpallë shenjtërinë e lirikës, por t’i japë lexuesit kënaqësi estetike. Teologët ia dedikojnë librat e shenjtë shpirtit, ndërsa lirikës i mjafton muza dhe frymëzimi shpirtëror i njeriut. Pitagora, e ndiente që shkronja vret, ndërsa shpirti ngjall, sikundër do të thuhej më vonë në Bibël. Por në fillim duhet t’i përgjigjemi pyetjes që përgjon me syrin vigjilues në shtegun e letërsisë: Mund të flitet për prozën apo tregimin lirik? Sigurisht, përderisa flitet për poezi lirike, mund të flitet edhe për tregimin ose prozën lirike. Dhe tani, si të kemi hequr një barrë të rëndë nga shpina, mund të vijojmë më tej rreth prozës ose tregimit lirik. Kur flasim për letërsinë lirike, përfytyrojmë lulet që shpërthejnë në stinën e pranverës dhe aromën e tyre dehëse, larminë e ngjyrave të mrekullueshme, me nuanca të gjithëfarëllojshme e marramendëse, freskinë dhe njomështinë e tyre, harenë, ngazëllimin, e sa e sa veti të tjera të rralla, pa të cilat shpirti ynë njerëzor nuk do të mund të ushqehet e flladitet, në këtë botë, ashtu sikurse thotë Bodleri, njëri prej lirikëve më të mëdhenj botërorë: “Kjo jetë është një spital, ku çdo i sëmurë ka veç një dëshirë, të ndryshojë shtratin.”.

Lirikat pasqyrojnë një gjendje të gëzuar ose edhe një gjendje të trishtuar të njeriut, të një fije bari që fërfëllin atje tej rrëzë një shkëmbi në gjirin e natyrës, një gjethe të gjelbër, një bisk, një gonxhe, një lule që ka shpërthyer me të gjithë dasmën e ngjyrave, jetën e gjatë të gjallesave ose të bimëve, sikurse edhe një çast të vetëm, por me një kusht, që kjo gjendje efemere të ngazëllejë shpirtin njerëzor, të prekë thellë ose të të hedhë përperjetë, njësoj si vala ujin në zjarr. Lirikat janë dallëndyshet e dashurisë. Sikurse rreziku, ato të japin ndjesinë e përjetimit të jetës në maksimum, ose po të shprehemi në mënyrë poetike, të nxisin ta rrëkëllesh me fund kupën e ëmbël ose të hidhur të jetës.

Lirikat ushqehen jo vetëm nga imagjinata e kujtesa për të kaluarën dhe ëndrrat për të ardhmen, por edhe nga diçka që shkrepstin e përflak shpirtin e njeriut. Kështu, edhe në gjendje “memece” ato flasin me heshtjen e tyre flatruese. Nuk di të them më tej nëse ato kanë të bëjnë edhe me vetë lirinë njerëzore, por në njëfarë kuptimi luajnë edhe rolin e “një skaneri” sepse nëpërmjet tyre, sikurse silvikultoret zbulojnë praninë e dimrave të egër nga shqyrtimi i madhësisë së rrathëve në trungun e një peme, dëshkohet dashuria për të bukurën në jetë, sikurse mungesa e tyre, shtrëngimet e regjimeve ndaj lirive të një shoqërie dhe rreziqet që kërcënojnë ta venisin atë. Ato të kujtojnë aromën e mjaltit të bletës, muzikën e tyre qiellore dhe vetë shenjtërinë e jetës.

Shikoni, edhe vetë mendja më gjeniale e njerëzimit të shekujve XIX-XX, shkencëtari Albert Ajnshtajni, pati paralajmëruar: “Trenkatër vjet pas zhdukjes së bletës do të zhduket edhe vetë jeta njerëzore!”. Për analogji do të dëshironim të përjasnim kësisoj edhe vlerat e lirikës ose lirizmit në art dhe në veçanti në fushën e letërsisë. Refuzimi i lirikës, ndoshta është ceni më i madh i një kohe, epoke, vendi, kulture e populli e kështu me rradhë, i barabartë me atë që populli e quan thjeshtë një mallkim. Lirika nuk është vetëm pranverë, por edhe vjeshtë e dimër, pra jetë e mbushur plot ndjenjë. Lirikat mund të shfaqen nën petkun e një lule vjollce të brishtë në maj, sikurse edhe në pamjen e një hirusheje të bukur.

Të mrekullon pamja magjike që përftohet nga çasti i lindjes ose i perëndimi të diellit në horizontin e një mali, një fushe ose deti të kaltër...Ndjenja lirike mund të përftohet edhe nga laboratorit njerëzor, nga shkrepëtima e një qerpiku, nga drita e ninzës së syrit të një fëmije të sapolindur, sikurse edhe nga zjarri i vështrimit të një vajze ose djaloshi të dashuruar... Natyra e prozës ose tregimit lirik nuk njeh norma e kanune. Lirizmi është produkt i një gjendjeje shpirtërore të njeriut. Lirizmi nuk mund të jetë prodhim i asnjë lloj makine, kompjuteri ose vegle sado e sofistikuar dhe sido që të zhvillohet shoqëria njerëzore, do të mbetet një veti e jashtëzakonshme dhe e pazëvendësueshme me të cilën natyra e ka pajisur njeriun në dallim ose kompensim nga gjithçka frymore dhe jofrymore në universin tonë. Lirika është

gjenia e ndjeshmërisë, që nuk do të tejkalohet kurrë, as në epokën e atomit. Vesa e mëngjesit që spërkat me rubin e margaritar barin dhe petalet e luleve u mëkon atyre pranverën, ndërsa lirika përflak me ndjenjat më të bukura rinore jetën e çdo moshe njerëzore. Sikur vetëm një çast të mendohet se lirizmi është produkt i harkut të një violine të Stradivarit ose i tastierës së pianos së Moxartit, do të na duhej t'i besonim pastaj edhe asaj pianos së çmendur të Montesksesë që besonte se binte vetë!

Të diskutosh për kufijtë e lirikës, të kërkosh t'i veshësh asaj një uniformë dhe t'i përcaktosh një rregull ose kanun, me gjithë zellin e duhur, do të ishte njësoj si të mbërtheje me një gozhdë në astarin e qiellit vijën e horizontit, e cila na duket sikur e shohim aq qartë në ditët me diell, por asnjëherë dhe kurrë nuk është e përcaktuar në kuptimin gjeografik e topografik. Por, kjo nuk na pengon të shprehim mendimin rreth lirikës, ku karakteri i subjektit të veprës mbart një sensualitet të lartë shprehës, melodiozitet tërheqës, një derdhje intensive emocionesh të hareshme ose të trishta, brenda të cilës gëlojnë e ziejnë ndjenjat, notat dhe ngjyrimet që të lëbyrin vështrimin. Nëse do të flisnim për një udhëtim ose orientim të lirikës, do të shenjonim të vetmin port ose liman në të cilin ajo mund të gjejë qetësinë e shpirtit: orientimin drejt muzikës, e pëlqyeshme kjo edhe nga qenie që nuk prodhojnë mendim, që nuk kërkon gjithmonë komoditetin e fjalës së menduar dhe të shkruar.

Lirika është tek era që këndon ose qan në koriye, në male ose fusha, në dimër e pranverë, shushurima e gjetheve në pyll, thekra që vallëzon nga puhiza e erës, shiu që breron mbi çati ose mbi gjethet e drurëve, një përrua që këndon kur zbret në luginë, pa folur pastaj për muzikën e larmishme të zogjve dhe kafshëve të tjera apo gugatjet e një fëmije...

Lirika njih edhe bardët e saj të spikatur. Veç nuk duhet të harrojmë për asnjë çast, se gara në këtë fushë nuk merr në konsideratë gjendjet shpirtërore normale. Në një farë kuptimi na lehtëson shembulli i një lumi kur shprehemi se ai nuk derdhet si të gjithë lumenjtë e tjerë, nga burimi në det, por si të ishte çmendur, vërshon në drejtimin e kundërt! As nuk mund të bëhet fjalë për kufijtë e lirikës, në një kohë kur ajo prodhon bukuri edhe nga tmërri! Asnjë përfytyrim njerëzor nuk është në gjendje të shuajë

kufijtë hapësinorë, sikurse hiret dhe bukuria e Hankos në vargjet e lirikës popullore!

Nuk bëhet fjalë për dy fshatra ose qytete, por për dy botë, të lidhura fort me njëra -tjetrën, si nata me ditën; bota e gjallë dhe ajo e të vdekurve:

*Hanko mos kalo mbi varre  
Se të vdekurit i ngjalle  
Të gjallët i vdiqe fare.*

Kur flitet për lirikën, nënkuptohet një gjendje sa e brishtë, ngazëllyese, prekëse, e gjelbër dhe jo e gjelbër, harlisëse, farfuritëse, vërshuese, inkandishente, aq edhe e thellë, vibruese e njerëzore. Kjo gjendje, ose i ka të gjitha ndjenjat dhe ngjyrat, kohët, (pa kohët) tingujt dhe heshtjen e thellë solemne, ose nuk i ka fare, ndaj dhe nuk ka të bëjë aspak me atë, lirizmin! Ja një copëz lirike nga Charl Bodler<sup>(1)</sup>, mendimet e të cilit mund të jenë edhe një manifest i lirikës botërore:

Dehuni parreshtur!

Duhet të jeni gjithnjë të dehur. Kjo është e gjitha, e vetmja gjë e rëndësishme. Për të mos e ndjerë barrën e tmerrshme të Kohës, që të dërrmon shpatullat e të përkul shpinën, duhet të deheni parreshtur.

Po me se? Me verë, me poezi ose me virtyt, si t'ju dojë zemra. Po vetëm dehuni.

*Dhe nëse ndonjëherë, në shkallët e një pallati, mbi barin e gjelbër të një hullie, apo në vetminë e zyrtë të dhomës suaj, iu ndodh që të zgjoheni, pasi dehja ka rënë ose është zhdukur krejt, pyesni erën, valën, yllin, zogun, orën e murit, çdo gjë që fluturon. Që rënkton, që rrokulliset, që këndon, pyeteni sa është ora... Dhe era, vala, zogu, ora e murit, t'ju përgjigjen: "Është ora që të deheni! Për të mos qenë skllëvërit e kohës, dehuni, dehuni parreshtur! Me verë, me poezi ose me virtyt, si t'ju dojë zemra!*

<sup>(1)</sup> Charl Bodler (1821-1867), poet i shquar francez i cili me përmbledhjen poetike "Lulet e së keqes" i hapi rrugën poezisë moderne. Konsiderohet si i fundmi i romantikëve dhe i pari i modernëve.

Maksim Gorki duke shkruar mbi personalitetin e Anatol Fransit, vinte ne dukje:

*“Ai i besonte vetëm një të vërtete: të bukurës. Në recensionin për librin e zotit Burdo të titulluar “Gjynahet e historisë” ai ka shprehur ca fjalë si të derdhura në flori të kulluar këtë mendim:*

*“Po të më duhej të zgjidhja midis të vërtetës dhe të bukurës, unë pa u lëkundur do të mbaja të bukurën, i bindur plotësisht se ajo përmbush në vetvete të vërtetën më të lartë dhe më të thellë se vetë e vërteta”.*

Nisur nga pasuria e vërtetë artistike që mishëron proza lirike, shkrimtarët që e krijojnë atë janë të rrallë dhe të veçantë. Heronjtë e novelës së Leon Tolstoit “Sonata e Krojcerit”, dyshojnë nëse mund të mbahet ndezur për të gjithë jetën një dashuri. Sipas njërit prej tyre, kjo do të ishte njësoj si të duash të mbash të pashuar flakën e një qiriu! I njëjti dyshim mbetet edhe për lirikën. A nuk ngjasojnë gjendjet shpirtërore të njeriut, fshehur thellë në zgafellat e shpirtit, me metalin e floririt, nën tokë, në sasi të kursyera, me ngjyrën verbuese të rrezeve të diellit, duke u shndërruar me të drejtë në simbolin e forcës dhe pasurisë materiale të njeriut?!

Letërsia lirike, në poezi ose prozë, me cilësitë artistike që mishëron, ashtu sikurse dje, edhe nesër, do t’i hedhë para hundës pushtetit të floririt dhe parasë dorashkën sfiduese.

Ky botim, “Pena e vjeshtës së artë”, synon t’i japë lexuesit kënaqësinë e njohjes me një pjesë të konsiderueshme të krijimtarisë në fushën e tregimit lirik shqiptar. Dhe si gjithçka tjetër në fushën e artit, ai nuk mund t’i shpëtojë qëndrimeve subjektive, por ndoshta pikërisht për këtë të ofrojë edhe vlerat e tij.